



A.nr.757/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Arben Mehmeti, kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurën sipas ankesës A.nr.757/2026, të datës 07.07.2026, të parashtruar nga ankuesja S.B, nga Lipjani, kundër organit të punësimit: Shërbimit Korrektues të Kosovës, në çështjen juridike “*transferim sipas rristurimit*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 04.08.2026, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr.757/2026, e datës 07.07.2026, e parashtruar nga ankuesja S.B.

II. Mbetet në fuqi Vendimi me Nr.R.SHKK 116/2026 i datës 29.05.2026, i protokolluar më datë 08.06.2026, i ushtruesit të detyrës së Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Digjitalizimit dhe Administratës Publike.

A r s y e t i m

Ankuesja S.B (*në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja*) më datë 07.07.2026, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.R. SHKK 116/2026 të datës 29.05.2026, të protokolluar më datë 08.06.2026, të ushtruesit të detyrës së Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Digjitalizimit dhe Administratës Publike, për shkak të shkeljes së dispozitave procedurale, vërtetimi të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, mungesës së arsytimit të mjaftueshëm administrativ dhe cenim i parimeve të ligjshmërisë, proporcionalitetit, transparencës, meritës dhe sigurisë juridike lidhur me transferimin e saj për shkak të rristurimit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 09.07.2026, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Shërbimi Korrektues i Kosovës, ndërsa, ky i fundit, më datë 10.07.2026, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejshëm referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritorë administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 2971/2026 të datës 07.07.2026, të ankueses drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr. R. SHKK 116/2026 të datës 29.05.2026, të protokolluar më datë 08.06.2026, të ushtruesit të detyrës së Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Digjitalizimit dhe Administratës Publike; Përshkrimin e punës për pozitën Zyrtar Administrativ; Akt Emërimit të datës 26.03.2013 të ankueses; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Zyrtar Financiar datës 20.03.2024; Kopjen e ID-së së ankueses; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 09.07.2026; Përgjigjen në ankesë e datës 10.07.2026; Vendimin e datës 26.02.2026 për themelimin e Komisionit të Ristrukturimit në SHKK; Raportin përfundimtar të Komisionit të Ristrukturimit i datës 26.05.2026; Plotësim/ndryshimin e raportit përfundimtar të Komisionit të Ristrukturimit i datës 04.06.2026; Diplomën e ankueses.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankueses **është e pabazuar, sepse:**

Nga administrimi i provave të lëndës rezulton se Kryeministri i Republikës së Kosovës, ka miratuar Rregulloren (ZKM) Nr.18/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Shërbimit Korrektues të Kosovës, me ç'rast procesi i organizimit të Shërbimit Korrektues të Kosovës, është pasuar me shuarje të pozitave, ndryshime në emërtime të pozitave përkatëse si dhe ndryshime në përshkrimin e detyrave dhe kriterëve të punës për pozita të caktuara.

Ushtruesi i detyrës së Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Digjitalizimit dhe Administratës Publike me Vendimin me numër V.Nr. 176/2026, të datës 26.02.2026, ka themeluar Komisionin e Ristrukturimit për Shërbimin Korrektues të Kosovës, ku ky i fundit, më datë 26.05.2025, ka miratuar Raportin përfundimtar lidhur me procesin e ristrukturimit në SHKK si dhe raportin plotësues më datë 04.06.2026, ashtu që ankuesja është propozuar të transferohet nga pozita Zyrtar për Financa, në pozitën Zyrtar Administrativ në Qendrën Korrektuese dhe Edukuese për të Mitur në Lipjan-Divizioni për Shërbime Profesionale dhe Teknike.

Në zbatim të rekomandimeve të Komisionit të Ristrukturimit, ushtruesi i detyrës së Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë Digjitalizimit dhe Administratës Publike, më datë 29.05.2026, ka nxjerr Vendim me Nr.R.SHKK 116/2026 të protokolluar më datë 08.06.2026, për transferimin e ankueses nga pozita Zyrtare për Financa në pozitën Zyrtare Administrative në Divizionin për Shërbime Profesionale dhe Teknike në Qendrën Korrektuese dhe Edukuese për të Mitur në Lipjan.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundërshton ligjshmërinë e Vendimit me Nr.R.SHKK 116/2026 të datës 29.05.2026, të protokolluar më datë 08.06.2026, të ushtruesit të detyrës së Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Digjitalizimit dhe Administratës Publike, duke pretenduar se vendimi i kontestuar nuk ka arsyetim dhe është një arsyetim i përgjithshëm sipër raportit të Komisionit të Ristrukturimit. Nuk është konstatuar nëse një proces i tillë është bërë në mënyrë transparente dhe ligjore, sepse transferimi nga një pozitë financiare në një pozitë administrative përbën veprim të kundërligjshëm. Kërkon që të aprovet ankesa, të anulohet apo shfuqizohet vendimi i kontestuar, të obligohet DMZP të rishqyrtoj rastin duke bërë vlerësim të plotë individual.

Në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankueses lidhur me të drejtën e saj të sistemimit për shkak të riorganizimit, Kolegji i Këshillit, iu referua dispozitave të nenit 66 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrat Publike, i cili përcakton se: *“1. Nëse për shkak të shuarjes apo ristrukturimit të institucionit, pozita e mëparshme e një nëpunësi/i civil shuhet, ajo/ai mund të transferohet në një pozitë tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori. 2. Transferimi, sipas paragrafit 1. të këtij neni, mund të bëhet: 2.1. në të njëjtin institucion; 2.2. në institucionin që është bashkuar institucioni i shuar, në institucionin që është ndarë apo në institucionin që ka marrë funksionet që kryente më parë nëpunësi/i; 2.3. në agjencinë ekzekutive të institucionit të ristrukturuar; 2.4. në një institucion tjetër të shërbimit civil. 3. Në çdo rast shuarje apo ristrukturimi të institucionit krijohet komisioni i ristrukturimit që shqyrton mundësitë e sistemimit të çdo nëpunësi/i civil në vendet e lira ekzistuese dhe propozon transferimin e nëpunësit/it në një pozitë të lirë, për të cilën i plotëson kërkesat e vendit të punës. 4. Vendimi përfundimtar i transferimit merret nga njësia përgjegjëse në bazë të propozimit të komisionit. 5. Nëpunësi/i mund të refuzojë transferimin vetëm për arsye të parashikuara në paragrafin 3. të nenit 63 të këtij ligji. Refuzimi i transferimit për arsye të tjera, përbën shkak për lirim nga shërbimi civil. 6. Komisioni i ristrukturimit, i parashikuar në paragrafin 3. të këtij neni, drejtohet nga njësia përgjegjëse dhe në të bëjnë pjesë përfaqësues të institucioneve të parashikuara në nën-paragrafët 2.1., 2.2., 2.3. apo 2.4. të këtij neni, sipas rastit ku bëhet ristrukturimi përkatës...”*

Po ashtu Kolegji i Këshillit me rastin e vendimmarrjes ju referua edhe dispozitave të Rregullores (QRK) Nr.02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civilë, përkatësisht nenit 13, paragrafi 1, 2 dhe 3, ku përcaktohet: *“1. Nëse për shkak të shuarjes apo ristrukturimit të institucionit, pozita e mëparshme e një nëpunësi civil shuhet, ai mund të transferohet në një pozitë tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori. 2. Shuarja apo ristrukturimi i institucionit përcaktohet në legjislacionin përkatës për organizimin e administratës shtetërore dhe agjencive të pavarura. 3. Transferimi sipas paragrafit 1. të këtij neni, mund të bëhet: 3.1. në të njëjtin institucion; 3.2. në institucionin që është bashkuar institucioni i shuar, në institucionin që është ndarë, apo në institucionin që ka marrë funksionet që kryente më parë nëpunësi; 3.3. në agjencinë ekzekutive të institucionit të ristrukturuar; 3.4. në një institucion tjetër të shërbimit civil. dhe si rrjedhojë bazuar në frymën e këtyre normave juridike, Kolegji i Këshillit vlerëson se ristrukturimi është proces i ndryshimit të organizimit të institucionit si rezultat i ndryshimit të misionit dhe fushëveprimit të institucionit, bashkimit apo fuzionimit të dy apo me shumë institucioneve, shuarjes së institucionit-eve apo shuarjes së funksioneve të caktuara të institucionit përkatës, dhe rrjedhimisht si rezultat i riorganizimit të institucionit mund të ketë ndryshime të vendeve të punës, shkurtime (shuarje) të vendeve të punës apo ndryshime të kriterëve të vendeve të punës”, nenit 13 paragrafi 5, ku përcaktohet: ” 5. Komisioni në propozimin e tij për transferimin e nëpunësve për shkak të ristrukturimit të institucionit mbështetet në përshkrimet e vendeve të lira apo të atyre të krijuara të punës dhe kualifikimet dhe të dhënat e nëpunësve” dhe nenit 14 paragrafi 1 dhe 2, ku përcaktohet: *“1. DMZP për institucionet e administratës shtetërore apo NjMBNj për institucionet e tjera, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e marrjes së propozimit nga komisioni i ristrukturimit, vendos për transferimin e nëpunësit dhe njofton nëpunësin për vendimin. 2. Nëpunësi mund të refuzojë transferimin vetëm për këto arsye: 2.1. kur gjendja e tij shëndetësore, e dëshmuar me vërtetim mjekësor, e bën transferimin të pamundur; 2.2. nëse vendi ku transferohet gjendet më shumë se njëqind (100) km nga vendbanimi i nëpunësit civil”**

Rrjedhimisht bazuar në frymën e këtyre normave juridike, Kolegji i Këshillit, vlerëson se ristrukturimi është proces i ndryshimit të organizimit të institucionit si rezultat i ndryshimit të misionit dhe fushëveprimit të institucionit, bashkimit apo fuzionimit të dy apo me shumë institucioneve, shuarjes së institucionit-eve apo shuarjes së funksioneve të caktuara të institucionit përkatës, dhe rrjedhimisht si rezultat i riorganizimit të institucionit mund të ketë ndryshime të vendeve të punës, shkurtime (shuarje) të vendeve të punës apo ndryshime të kriterëve të vendeve të punës. Nisur nga ky fakt, Kolegji i Këshillit në bazë të provave materiale të çështjes, konstaton se ankuesja sipas Akt Emërimit të datës 26.03.2013, mbante pozitën Zyrtare e Financave, në Qendrën e Paraburgimit në Lipjan.

Nëse i referohemi Rregullores (ZKM) Nr.18/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Shërbimit Korrektues të Kosovës, me Kapitullin III janë paraparë Institucionet Korrektuese që janë Strukturë Organizative Ekuivalente me Departamentet dhe me nenin 33 të kësaj rregulloreje janë paraparë këto lloj Institucione Korrektuese: Qendra Korrektuese, Qendrat e Paraburgimit dhe Burgu i Sigurisë së Lartë, ndërsa me nenin 36 është paraparë Qendra Korrektuese dhe Edukuese Korrektuese për të Mitur në Lipjan me divizionet përkatëse: *Divizioni për Siguri dhe Operativë, Pavijonet, Divizioni për Shërbime Profesionale dhe Teknike dhe Divizioni për Arsimi, Programe, Punë dhe Çështje Sociale.*

Tutje referuar Shtojcës Nr. 1, të pika 15 Qendra Korrektuese dhe Edukuese Korrektuese për të Mitur në Lipjan, në asnjë prej divizioneve të kësaj qendre nuk është paraparë asnjë pozitë Zyrtar Financiar, pra sipas kësaj rregullore, rezulton se pozita e ankueses që ka mbajtur sipas akt emërimit të datës 26.03.2013 është shuar dhe nuk ekziston më, pra nëse i referohemi kësaj rregulloreje, në kuadër të Divizionit për Siguri dhe Operativ, janë paraparë këto pozita: *Udhëheqës i Divizionit për Operativ dhe Siguri, Mbikëqyrës i Lartë, Mbikëqyrës dhe Zyrtar Korrektues*, pra ankuesja nuk ka mundur të propozohet për transferim në këto pozita për shkak që përveç pozitës Udhëheqës i Divizionit për Operative dhe Siguri që është drejtues i ulët, pozitën tjetra janë pozita të uniformuara. Në Pavijon janë paraparë pozitën: *Udhëheqës i Pavijonit, Mbikëqyrës i Lartë, Mbikëqyrës dhe Zyrtar Korrektues*, pra edhe në këtë rast ankuesja nuk ka mundur të propozohet për transferim në këto pozita, ndërsa në Divizionin për Shërbime Profesionale dhe Teknike, janë paraparë pozitën: *Zyrtar i Lartë për Ekzekutim të Sanksioneve Penale dhe Zyrtar i Lartë për Lirim të Burgosurve*, ku janë paraparë në grupin ligjor, që sipas provave të lëndës ankuesja nuk plotëson kërkesat formale për këtë pozitë për shkak që për grupin ligjor kërkohet kualifikim arsimor Fakulteti Juridik, ndërsa pozitën tjetra që janë paraparë në këtë divizion janë: *Zyrtar Administrativ sipas klasës profesionale 2, Asistent Administrativ sipas klasës profesionale 3, Zyrtar për Depozita të Burgosurve sipas klasës profesionale 2, Asistent i Depos sipas klasës profesionale 3* e të gjitha këto pozita janë paraparë në Grupin e Administrimit të Përgjithshëm, ndërsa pozitën tjetra *Shef i Kuzhinës, Kuzhinier, Teknik i Mirëmbajtjes dhe Lavantari* janë pozita të Nëpunës teknik dhe mbështetës, ndërsa në Divizion për Arsimim, Programe, punë dhe Çështje Sociale, janë paraparë pozitën: *Udhëheqës i Divizionit për Arsimim, Programe, Punë dhe Çështje Sociale, Zyrtar i Lartë për Çështje Sociale, Zyrtar i Lartë për Çështje Psikologjike, Zyrtar i Lartë për Zbatimin e Programeve Risocializuese të Burgosurve Zyrtar i Lartë për Koordinim të Procesit Mësimor, Zyrtar i Latë për Edukim, Zyrtar për Aftësim Profesional për Elektricitet, Zyrtar për Aftësim profesion për ndërtimtari, Zyrtar për Aftësim Profesional për Hidroinstalim dhe Zyrtar për Aftësim Profesional.*

Kolegji i Këshillit, në bazë të këtyre fakteve, konstaton se pozita që ka mbajtur ankuesja Zyrtare e Financave, në kuadër të Qendra Korrektuese dhe Edukuese Korrektuese për të Mitur në Lipjan nuk është paraparë sipas Rregullores (ZKM) Nr.18/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Shërbimit Korrektues të Kosovës, te përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të Divizionit për Shërbime Profesionale dhe Teknike janë paraparë edhe detyra financiare, të pasurisë dhe mbështetje të planifikimit të buxhetit, e duke marr parasysh që ky përshkrim është përcaktuar me rregullore, Kolegji i Këshillit, konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk ka mandat dhe kompetencë të shqyrtoj ligjshmërinë e akteve nënligjore siç është rregullorja, andaj edhe nuk mund të lëshohet në konstatimin nëse përshkrimi i detyrave të punës të përcaktuar në rregullore është i drejtë apo jo. Rrjedhimisht sipas legjislacionit përkatës të cekur më lartë, ka qenë obligim i Komisionit të Ristrukturimit që të bëjë propozimin për transferim brenda kategorisë dhe në institucionin ku ankuesja punon duke marr parasysh edhe plotësimin e kërkesave të përgjithshme formale (arsimimin dhe përvojën e punës), kështu që sipas raportit përfundimtar të datës 26.05.2026 të Komisionit të Ristrukturimit, rezulton se ankuesja është propozuar të transferohet në pozitën Zyrtare Administrative në kuadër të Divizionit për Shërbime Profesionale dhe Teknike në Qendrën Edukuese Korrektuese për të Mitur në Lipjan, e që sipas përshkrimit të detyrave të punës së pozitës Zyrtar Administrativ, rezulton se ka edhe detyra financiare, e si rezultat i kësaj, propozimi për transferim në këtë pozitë për ankuesen është bërë në pajtim me përgatitjen e saj profesionale për shkak që e njëjta sipas provave të lëndës posedon Diplomën për kryerjen e shkollës së lartë Ekonomike-Komerciale ku ka marr titullin Ekonomist, pra sipas Kolegjit të Këshillit, Komisioni i Ristrukturimit në Shërbimin Korrektues të Kosovës, me rastin e propozimit për transferim të ankueses në pozitën Zyrtare Administrative, ka vepruar në pajtim me nenin 66 paragrafi 1, 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë dhe nenet 12, 13 dhe 14 të Rregullores (QRK) Nr.02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civilë.

Kolegji i Këshillit, thekson faktin se ankuesja edhe para ristrukturimit ka mbajtur pozitë të kategorisë profesionale klasa profesional 2, por edhe pas ristrukturimit pozita e saj ku është transferuar është kategorizuar si pozitë e kategorisë profesionale klasa profesional 2, andaj Kolegji i Këshillit, vlerëson se ankueses nuk i është cenuar ndonjë e drejtë e saj nga marrëdhënia e punës si rezultat i ristrukturimit, dhe meqenëse nuk ekzistojnë asnjëra nga arsyet ligjore për refuzim të transferimit siç parashihet me nenin 66 paragrafi 5 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, ndërlidhur me nenin neni 63 paragrafi 3 i këtij ligji ku është ka përcaktuar se: *“3. Transferimi i përkohshëm i nëpunëses/it civil, është vendim i drejtueses/it më të lartë të institucionit dhe mund të refuzohet nga shërbyesja/ i civil në këto raste: 3.1. kur gjendja e saj/tij shëndetësore, dëshmuar me vërtetim mjekësor, e bën transferimin të pamundur; 3.2. nëse vendi ku transferohet gjendet më shumë se njëqind (100) km nga vendbanimi i nëpunëses/it civil”*, Kolegji konstaton se nuk kanë mbështetje ligjore pretendimet ankimore të ankueses si në ankesë.

Kolegji i Këshillit mbi bazën e konstatimeve si më lartë, vlerëson se Komisioni i Ristrukturimit në rastin e propozimit për transferim të ankueses ka vepruar në pajtim me nenin 66 paragrafi 1, 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë dhe nenet 12, 13 dhe 14 të Rregullores (QRK) Nr.02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civilë, e për rrjedhojë edhe Vendimi me Nr.R.SHKK 116/2026 i datës 29.05.2026, i protokolluar më datë 08.06.2026, të ushtruesit të detyrës së Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Digjitalizimit dhe Administratës Publike, që derivon si rezultat i raportit të Komisionit të Ristrukturimit, është nxjerr në pajtim me nenin 66 paragrafi 4 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, si dhe nenin 14 të Rregullores (QRK) Nr.02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civilë

dhe po ashtu akti kontestuar përmban elementet e aktit administrativ të përcaktuar me nenin 47 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, arsyetimi është dhënë në kuptim të raportit të komisionit të ristrukturimit, kështu që pretendimet ankimore të ankueses ndaj aktit të kontestuar janë të pabazuara.

Nga ajo që u tha si më lartë, e duke u bazuar nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda:A.nr.757/2026, datë 04/08/2026

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses S.B;
- Njesisë për Burime Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së